

FITIM RIFATI**SINKRONI E KRIMEVE SERBE NË MORAVË TË EPËRME
(SHTATOR-DHJETOR 1913)****Përkufizim i shkurtër gjeodemografik e administrativ
i Moravës së Epërme dhe i krimeve serbe kundrejt
shqiptarëve në fillim të shek. XX**

Morava shtrihet në lindje të fushës së Kosovës e në veri të maleve të Karadakut dhe ndahet në dy pjesë: Morava e Poshtme dhe Morava e Epërme. Kjo trevë gjeografike ka marrë këtë emërtim sipas homonimit-hidronimit Morava, që rrjedh nga malet e Karadakut, përkatësisht në jug të Vitisë. Kjo hapësirë gjeografike përfshin vendbanimet e Karadakut, një pjesë të Gallapit, Zhegotit dhe Novobërdës.¹ Morava e Epërme shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës, në shpatet veriore të Karadakut të Shkupit, duke përfshirë luginën e lumit Morava. Kufizohet me Gjilanin, Ferizajin, Kaçanikun dhe Maqedoninë.²

Sipas një regjistri osman të vitit 1901, i cili e rendit popullsinë e kësaj treve në bazë të përkatësisë religjioze, struktura etnike e popullsisë paraqitet e tillë: Ballancë (179 myslimanë), Beguncë (249 myslimanë), Binçë (392 myslimanë), Budrikë e Epërme (195 myslimanë), Budrikë e Poshtme (24 myslimanë dhe 242 jomyslimanë), Debelldeh (117 myslimanë), Devajë (67 myslimanë dhe 58 jomyslimanë), Drobesh (297 myslimanë), Gërmovë (202 myslimanë), Gërçar (217 jomyslimanë), Gjylekarë* (376 myslimanë), Kabash (194 myslimanë), Kllokot (312

¹ Kadri Halimi, "Gjilani - vështrime antropogjeografike", *Përparimi* (revistë kulturore), nr. 11, Prishtinë: 1959, f. 774-775; Drita Halimi-Statovci, "Gjilani, struktura dhe funksionet si qendër regionale", *Kosova*, nr. 3, Prishtinë: Enti i Historisë së Kosovës, 1974, f. 261-262; Fehmi Rexhepi, "Moravë e jo Pomoravle, as Moravë e Kosovës", *Rilindja*, e mërkurë, 18 shkurt 1981, f. 11; Aliriza Selmani, *Gjilani, qendër e Anamoravës nga themelimi deri në gjysmën e parë të shekullit XX*, Ribotim i plotësuar, Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri", Gjilan: 2017, f. 23.

² Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës (Vitia)*, vëllimi 7, Prishtinë: Shkrola, 2004, f. 15.

* Sot Skifteraj në komunën e Vitisë.

jomyslimanë), Letnicë (171 jomyslimanë), Lubishtë (426 myslimanë), Mogillë (161 myslimanë dhe 581 jomyslimanë), Partesh (25 myslimanë dhe 329 jomyslimanë), Podgorc (50 myslimanë dhe 85 jomyslimanë), Pozharan (555 myslimanë dhe 180 jomyslimanë), Qifllak (45 myslimanë dhe 43 jomyslimanë), Radivojc (86 myslimanë dhe 154 jomyslimanë), Ramjan (150 myslimanë), Remnik (325 myslimanë dhe 90 jomyslimanë), Sadovinë e Çerkezëve (330 myslimanë), Sadovinë e Jerlive (132 myslimanë), Sllatinë e Epërme (295 myslimanë), Sllatinë e Poshtme (160 myslimanë), Smirë (461 myslimanë), Stubëll (245 myslimanë dhe 245 jomyslimanë), Shoshare (519 jomyslimanë), Tërpezë (212 myslimanë dhe 130 jomyslimanë), Tërstenik (246 myslimanë), Vërban (319 myslimanë), Vërboc (478 jomyslimanë), Vërnakoll (269 jomyslimanë), Viti (911 jomyslimanë), Vrnez (243 jomyslimanë), Zhiti (143 myslimanë dhe 144 jomyslimanë). Lidhur me këtë, vlen të nënvizohet se struktura etnike e popullsisë së kësaj treve në masë të konsiderueshme kishte fizionomi shqiptare me përkatësi religjioze myslimane dhe të krishterë (katolike dhe ortodokse).³ Në përgjithësi, në rrethin e Gjilanit sipas statistikave osmane e austro-hungareze, popullsia shqiptare përbënte shumicën si para dhe pas pushtimit e aneksimit serb.⁴

Edhe pas pushtimit serb nga tetori 1912, Morava e Epërme përfshihej në kuadër të rrethit administrativ të Gjilanit. Nën sundimin e ri, statusin administrativ të komunave e gëzonin: Vitia, Vërboci, Parteshi, Sllatina dhe Tërpeza.⁵ Në bazë të ndarjes së re administrative, ku vendbanimet kryesisht me popullsi serbofone marrin status të veçantë, nënkuptohej se Mbretëria e Serbisë i dha rol specifik elementit serb në Moravë të Epërme për zbatimin dhe sendërtimin e politikave të saj, që

³ Agron Islami, "Popullsia e kazasë së Gjilanit sipas regjistrimeve osmane të shekullit XIX-XX", *İslâm Araştırmaları Dergisi/ Journal of Islamic Studies*, year 3, spring, issue 5, Edirne-Turkiye: Trakya Üniversitesi Birligif, 2020, f.74-83.

⁴ Kristaq Prifti, *Popullsia e Kosovës (1831-1912)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2014, f. 939; Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2013, f. 45.

⁵ *Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës* (më tej: ASHAK), Fondi: Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë – Korrespondenca sekrete (1913-1915), kutia nr. 8. Raport nga Beogradi nr. 8999 mbi ndarjen administrative të rajoneve të pushtuara, Beograd, 24 gusht 1913; Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës (Gjilani)*, vëllimi 6, Prishtinë: Shkrola, 2005, f. 36, 48; Милош Јагодић, *Нови крајеви Србује (1912-1915)*, Прво издање, Београд: Филозофски факултет, 2013, f.106, 122.

ekskluzivisht orientoheshin në disfavor të popullsisë shqiptare, e cila konsiderohej e parëndësishme dhe trajtohej në mënyrë të papërfillshme.

Përmasat e krimeve shtetërore, ushtarake, administrative dhe civile serbe ndaj shqiptarëve të kësaj treve në muajt e fundit të vitit 1912 dhe fillimit të vitit 1913, janë pjesërisht të njohura. Bastisjet individuale e kolektive me pretekst çarmatimin e popullsisë shqiptare nëpër shtëpi e fshatra të kësaj treve ishin bërë thuajse përditshmëri. Kësisoj, është e shënuar masakra e ushtrisë serbe në Tërstenik (60 veta), në tetor 1912; në Goshicë (58 veta), në tetor 1912; në Smirë (83 veta), në nëntor 1912; në Lubishtë (18 veta), në dhjetor 1912 dhe 84 veta në shkurt 1913; në Vërban (20 veta), tetor-dhjetor 1912; në Mogillë (20 veta), në janar 1913 etj.⁶ Ato janë pasqyruar edhe në shtypin ndërkombëtar, i cili për së afërmi ka ndjekur zhvillimet dramatike gjatë Luftës së Parë Ballkanike. “Në Gjylekarë një shtatzanë e vdekun e kish barkun të premë me bajonetë, e pjella ende po i lëvizte në bark” - raportonte ato ditë Leo Freundlich.⁷ Veç kësaj, të dhëna me interes janë paraqitur edhe në komunikimet zyrtare të ushtrisë serbe të kohës. Më 15 shkurt 1913, Komanda e vendit në Gjilan i raportonte Komandantit të Divizionit të Kosovës lidhur me ekzekutimin e 68 shqiptarëve të fshatit Lubishtë, ku ndër të tjera, i shkruante: “...Një njësi... me dinamit i ka shkatërruar shtëpitë dhe i ka vënë zjarrin disa kullave dhe disa shtëpive të arnautëve kryengritës. Të gjithë arnautët të lidhur (68) nga ai fshat, i kanë çuar në një pyll, ku më herët fshatarët e fshatit Vërboc i kanë hapur gropat dhe aty me ta (njësi ushtarak - F.R.) ka vepruar sipas procedurës së shkurtër”.⁸ Këto akte terrori e shkatërrimi të tërësishëm të një elementi kombëtar me karakteristika kulturore dhe gjuhësore të veçanta nuk ishin të pazakonshme, sepse vijuan edhe në muajt pasues të vitit 1913, duke marrë dimension të ri nga shtatori në dhjetor.

⁶ Nexhmedin Z. Bardhi, *Pushtimi dhe politika represive serbe në Anamoravë (1912-1915)*, Prishtinë: Grafobeni, 2014, f.177-214.

⁷ Leo Freundlich, *Golgota e Shqipnisë – aktakuzë kundër shfarosësve të popullit shqiptar*, Prishtinë: Rrokullia, 2010, f.22.

⁸ *Архив Војноисторијског Института - Београд* (më tej: АВИБ), П. 2, К. 13, Ф. 1, бр. 1/71, Команда Места Гњилане Команданту Косовске Дивизије, 2. фебруар 1913 год.

Shpallja e aneksimit serb, reagimi shqiptar dhe krimet në Moravë të Epërme

Menjëherë pas pushtimit dhe ligjësimit nga Fuqitë e Mëdha të aneksimit serb të Kosovës, organet shtetërore morën masa për të nxjerrë ligje e mekanizma të administrimit ushtarak, policor, gjyqësor e financiar të lidhura drejtpërdrejtë me organet përkatëse në Beograd.⁹ Veç kësaj, zyrtarë të shtetit serb deklaruan se Mbretëria e Serbisë nuk do të respektonte vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër mbi mbrojtjen e pakicave.¹⁰ Mirëpo, shqiptarët nuk e pranuan pushtimin serb dhe nuk u pajtuan me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, për aneksimin e viseve të tyre Mbretërisë së Serbisë. Në fillim të muajit shtator të vitit 1913, krerët shqiptarë sapo u njohën me vendimin për aneksimin e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare, përmes një memorandumit të dërguar nga Kosova, menjëherë kërkuan nga ministrat e Punëve të Jashtme të gjashtë Fuqive të Mëdha të rishikonin vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe të përmirësonin padrejtësitë kombëtare ndaj shqiptarëve. Ata ankoheshin për dhunën, represionin dhe mizoritë që po përjetonin si pasojë e regjimit serb.¹¹ Mirëpo, shqetësimet e tyre nuk u morën parasysh nga Fuqitë e Mëdha e as nga shtetet ballkanike. Si rrjedhojë e mospërfilljes së kërkesave të tyre, rrugë e vetme ishte organizimi i një kryengritjeje të armatosur për çlirimin e viseve shqiptare të aneksuara Mbretërisë së Serbisë dhe Malit të Zi.¹²

⁹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III (Periudha e pavarësisë 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f.425.

¹⁰ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSSt.A.P.A.A.*), në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj.23-36-3639. Raport konfidencial i zëvendëskonsullit austro-hungarez në Prizren, Rudolf Kohlruss, dërguar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Leopold Berchtold, Prizren, 15 tetor 1913.

¹¹ "Memorandum i Kosoves", në *Liri e Shqipërisë*, Viti i III, nr. 85, Sofje, 28 Vjesht'e I-re 1913, f. 2; Marenglen Verli, "Situata në trevat shqiptare lindore të pushtuara dhe qëndresa antiserbe (tetor 1912-shtator 1913)", *Studime historike*, nr. 3-4 (2004), viti LVIII (XLI), Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë: 2004, f.163.

¹² *Пујемонт*, "Арнаути спремају буну?", Број 244 (година III), Београд, четвртак, 5. Септембра 1913. год., стр. 2.

Me rastin e shpërthimit të Kryengritjes shqiptare të shtatorit të vitit 1913, në Kosovë ekzistonte një frymë autonomiste si fazë kalimtare drejt bashkimit me Shqipërinë. Kjo frymë e re i kishte rënë në sy nënkonsullit britanik në Shkup, Walter Divie Peckham. Sipas pikëpamjes së tij, ekzistonin dy arsye kryesore të këtij ngazëllimi: *“E para, shpallja zyrtare e aneksimit po i hidhëron njerëzit (shqiptarët - F.R.), të cilët janë ngirë me administrimin serb dhe që do ta përcillnin me shpejtësi mysafirin në ikje madje me më shumë entuziazëm seç e kishin para një viti; dhe e dyta, aneksimi ka qenë sinjal për një orgji të re taksash serbe. Dogana po zbaton tarifa serbe ndaj mallit të arritur, por që nuk kishte kaluar doganën para aneksimit”*.¹³ Kësisoj, besimi për një status autonom-administrativ të shqiptarëve nën Mbretërinë e Serbisë ishte i përkohshëm, ndërsa aneksimi zyrtar i Kosovës i humbi përfundimisht shpresat politike të shqiptarëve. Në këtë kontekst, abuzimi serb me taksat dhe tatimet përbënte një politikë të rëndë për mbijetesën ekonomike të shqiptarëve.

Kryengritja e shqiptarëve kishte revoltuar në shkallë të lartë autoritetet qeveritare dhe administrative serbe. Në diskursin politik serb, qëllimi për shkatërrimin e tërësishtëm të shqiptarëve ishte bërë publik nga përfaqësuesit dhe drejtuesit administrativë. Prefekti i Shkupit kishte deklaruar publikisht se *“dy kamionë me dinamit që posa kanë ardhur janë për këtë qëllim”*. Në këtë kuadër, qeveria serbe bënte qëllimisht përpjekje aktive për të nxitur të gjithë shqiptarët në kryengritje *“si arsyetim për t’i masakruar”* më pas.¹⁴ Në këtë kohë, ajo proklamoi një dekretligj, i cili do të luftonte individët dhe grupet kryengritëse shqiptare. Projektligji parashihte jo vetëm dëbimin e dhunshëm të familjeve të kryengritësve, por spastrimin etnik të të gjitha vendbanimeve të tyre ku ata gjenin strehim dhe përkrahje. Në të gjithashtu parashihej internimi e shpërngulja e dhunshme në viset e vjetra të Mbretërisë së Serbisë, ndërsa viset dhe shtëpitë e shqiptarëve të internuar dhe dëbuar dhunshëm do të zëvendësoheshin me banorë serbë nga rajone të vjetra dhe të reja të Mbretërisë së Serbisë. Sipas dekretligjit, parashiheshin dënime nga 6-20 vjet burgim, por edhe pushkatim i të akuzuarve. Nuk lejohej bashkimi i më shumë se 5 vetëve që vlerësoheshin të rrezikshëm ose bënin

¹³ Robert Elsie & Bejtullah Destani (redaktorë), *Kosova: një histori dokumentare nga Luftërat Ballkanike deri në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë: Koha, 2019, f. 260. Depeshe e W. D. Peckham nga Shkupi dërguar Dayrell Crackanthorpe në Beograd, 22 shtator 1913.

¹⁴ *Po aty*.

propagandë kundër shtetit serb dhe organeve të administratës. Madje, sipas këtij dekretligji të gjitha organet e administratës ushtarake kishin të drejtë pa vendim gjyqësor të vrisnin të akuzuarit.¹⁵

Situata e tensionuar dhe e ndërlikuar paralelisht kaploi rrethin e Gjilanit, në kuadër të të cilit përfshihej edhe Morava e Epërme. Në shtator të vitit 1913, organet e administratës serbe, për shkak të panikut dhe mungesës së mjaftueshme të forcave ushtarake, raportonin se lëvizje kryengritëse parashihej të kishte edhe në rrethin e Gjilanit.¹⁶ Rrjedhimisht, mobilizimi dhe lëvizja e trupave ushtarakë serbë në drejtim të viseve të Moravës së Epërme ishte e vogël. Më 23 shtator 1913, sipas informatave që kishte në dispozicion konsullata austro-hungareze në Mitrovicë, raportohej se një kompani këmbësorie ishte nisur nga Prishtina për në Gjilan.¹⁷

Në këto rrethana, për shtetin serb ishte rast i volitshëm që të shfrytëzonte kryengritjen e shqiptarëve në favor të angazhimit të të gjitha forcave, për të intensifikuar shkallën e mizorive kundrejt shqiptarëve, përfshi edhe Moravën e Epërme. Forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe, si organizime të kontrolluara nga shteti, përlligjinin agresionin dhe brutalitetin e tyre si masa defensive, gjoja të paplanifikuara kundër popullsisë shqiptare. Në vijim të kësaj politike, vrasje e masakra ndaj popullsisë shqiptare u realizuan në rrethin e Gjilanit. Sipas burimeve që kishte siguruar konsullata e Përgjithshme austro-hungareze në Shkup në krye me konsullin Heinrich Jehlitschka, në Moravë të Epërme “*midis 21 dhe 23 tetorit, u vranë 17 muhamedanë (shqiptarë - F. R.) dhe u çnderuan shumë gra dhe vajza. Thuhet se në malet e atjeshme gjinden ende shumë kufoma të pavarrosura*”.¹⁸ Popullsia shqiptare myslimane e kësaj treve nuk kishte guxim, në përgjithësi për shkaqe sigurie mbi jetën e saj, të shkonte në xhami për të kryer lutjet e përditshme. Mekanizmat

¹⁵ *HHSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 23-36-3633. Informacion konfidencial i zëvendëskonsullit austro-hungarez në Prizren, R. Kohlruss, dërguar MPJ në Vjenë, Prizren, 17 shtator 1913; Liman Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë (1918-1928)*, Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, Prishtinë: 2016, f. 18.

¹⁶ М. Јагодић, *Нови крајеви...*, f.243.

¹⁷ *HHSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 23-17-1796. Raport i konsullatës austro-hungareze në Mitrovicë dërguar Wilhelm von Storck në Beograd, Mitrovicë, 29 shtator 1913.

¹⁸ *Po aty*, Vj. 23-30-3064. Raport shumë rezervat i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, Heinrich Jehlitschka, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 24 tetor 1913; Limon Rushiti, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë (1912-1918)*, Prishtinë: Rilindja, 1986, f.39-46.

ushtarakë dhe administrativë serbë kishin bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me elementin serb në Moravë të Epërme. Ata ishin në të vërtetë partnerët kryesorë për realizimin e doktrinës politike serbe kundrejt popullsisë shqiptare. Grupet komitë serbë, si formacione të veçanta të organizuara nga qeveria dhe ushtria, zakonisht gjatë orëve të natës shtinin me armë, si metodë efektive për krijimin e një preteksti për vrasjen e popullsisë civile shqiptare. Gjithnjë, mbështetur në përvojën pothuajse njëvjeçare nga pushtimi serb dhe në burime të mirëbesueshme informacioni, konsullata e Përgjithshme austro-hungareze në Shkup nxirrte konstatime dhe përfundime të besueshme. Më 24 tetor 1913, sipas raportit të saj dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë në Vjenë, në mënyrë të qartë vihej në konstatimin se *“mizoritë e përmendura si edhe shumica e mizorive të tjera serbe nuk janë akte të brutalitetit spontan, të bëra gjatë betejave të rrepta, nga ushtarë të vrazhdë dhe të egërsuar, por në të vërtetë kemi të bëjmë me një fushatë eliminimi ose shfarosjeje, të zhvilluar sikur duket me urdhër nga lart”*.¹⁹ Rrjedhimisht, adresa kryesore e përpilimit dhe kryerjes së akteve të dhunës, që në esencë kishin për qëllim eliminimin dhe shkatërrimin e popullsisë shqiptare, ishte Beogradi zyrtar, i cili urdhëronte institucionet administrative për të zbatuar me përpikëri direktivat shtetërorë.

Shkatërrimi i tërësishëm i shqiptarëve, pikëpjekja programore e të gjitha strukturave shtetërore serbe

Mbretëria e Serbisë prej vitesh kishte një platformë të trashëguar e të artikuluar politike dhe kombëtare përbrenda territorit të saj, e cila sqaronte në hollësi pozicionin dhe qëndrimin e shtetit serb kundrejt popullsisë joserbe. Forumet dhe mjediset radikale e ekstremiste serbe nga pallati mbretëror, kuvendi, qeveria, administrata në qarqe, rrethe e komuna, mekanizmat e rendit dhe të sigurisë, shoqëria civile, grupet akademike e gazetareske, strukturat shtetërore serbe etj., kishin qëndrim unanim në funksion të shërbimit dhe realizimit të platformës shoviniste shtetërore.

Gjatë muajve shtator-dhjetor 1913, programi shtetëror, i cili mbështetej në parullën kryesore *“Serbizim me çdo çmim”*, u zbatua në formën më brutale dhe pa kurrfarë mëshire kundrejt popullsisë joserbe.

¹⁹ *Po aty.*

Ai kishte për synim tjetërsimin, asimilimin dhe serbizimin e të gjithë elementëve të popullsisë joserbe, eliminimin, ekzekutimin ose shkatërrimin e individëve dhe grupeve opozitare apo kundërshtarë të pushtetit, konfiskimin e tokave që nuk u përkisnin serbëve, për të sistemuar në to popullsi serbe. Në këtë kuadër, parashihej të ushtrohej serbizimi i detyruar i antroponimisë së personave, persekutim i vazhdueshëm i katolikëve, myslimanëve, mbyllja e xhamive, heqja e mbulesave të kokës (plisit, fesit e shamisë) për gratë dhe burrat.²⁰

Në prapavijën politike, pavarësisht shkallës së intensitetit, krimi kundrejt popullsisë në fshatra kishte për rrjedhojë shkatërrimin e tërësishëm të shqiptarëve myslimanë. Masakrat i hapnin rrugën arritjes së një qëllimi tjetër të paraparë në doktrinën politike-shtetërore. Si rrjedhim, pronat pa pronarë, për shkak të asgjësimit të pronarëve të tyre, kalonin nën zotërimin e qeverisë, për t'i mundësuar zbatimin e politikës së kolonizimit, në shërbim të qëllimeve të saj. Kësisoj, përveç tokave që ishin pa pronarë, për shkak se ata kishin ikur ose kishin emigruar si pasojë e mizorive të vazhdueshme serbe, kategorive të tokave pa pronarë i shtoheshin edhe ato të pronarëve të ekzekutuar ose masakruar. Pra, në disa raste ndodhte konfiskimi e në disa raste rekuizimi i tokave, sidomos ndaj pronave që emigrantët nuk kishin mundësi t'i shisnin. Në këtë kontekst, një mjet tjetër i qeverisë serbe për uzurpimin e pronave ishte shqyrtimi i titujve të pronësisë, të cilët shpeshherë mund të vërtetoheshin me vështirësi, për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës dhe mosgatishmërisë së administratës shtetërore për njohjen e dokumenteve të pronësisë që ishin në gjuhën osmane. Rrjedhimisht, duke qenë pronarë e madhe tokash, administrata qeveritare serbe kishte për qëllim të zhvillonte "*menjëherë një veprimtari të dendur kolonizimi*". Pra, objektivi i dhurimit të tokave ishin familjet e ushtarakëve të rënë në luftë, serbëve ose elementëve të tjerë të afërt me serbët si për nga gjaku, fisi dhe gjuha. Për këtë qëllim, Mbretëria e Serbisë po planifikonte që në Shkup të formonte një qendër agjitacioni, e cila kishte për qëllim zhvillimin e mëtejshëm të politikës së kolonizimit në "Serbinë e Re".²¹ Përkundrazi, qarqet opinioniste serbe me mendim demokrat dhe progresiv, ishin të bindura se në viset e reja të Mbretërisë së Serbisë ekzistonte një anarki e

²⁰ *Po aty*.

²¹ *HHS*A.P.A.A. në *AIH*, Vj. 23-30-3064. Raport shumë rezervat i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, H. Jehlitschka, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 24 tetor 1913.

plotë dhe fajtores për këtë ishte qeveria serbe. Prandaj, përgjegjësia kryesore në radhë të parë peshonte ekskluzivisht mbi kryeministrin serb Nikolla Pashiq.²²

Zbatimi i strategjisë shtetërore, që kishte për synim përjetësimin e sundimit serb në viset e aneksuara shqiptare, duke përdorur si pretekst lëvizjet e armatosura të shqiptarëve, i dha rast organeve përkatëse të rendit dhe sigurisë, ushtrisë dhe forcave paraushtarake e çetnike serbe, për t'u treguar tmerrësisht agresive dhe për të kryer barbarizma, madje edhe në ato treva ku kryengritja nuk pati jehonë të gjerë, përfshi edhe Moravën e Epërme.²³ Në këtë kontekst, ambasadori britanik në Beograd, Dayrell Crackanthorpe, më 5 nëntor 1913, i shkruante eprorit të tij në Londër, Edward Grey, se pas sprapsjes së shqiptarëve fushata e trupave serbë ndaj popullsisë së pambrojtur "është karakterizuar nga egërsia më e madhe dhe kjo përtej çdo dyshimi".²⁴ Pra, thujse të gjithë përfaqësuesit diplomatikë të Fuqive të Mëdha të akredituar në Mbretërinë e Serbisë, që shprehnin interesim rreth gjendjes së popullsisë në Moravë të Epërme dhe vise të tjera të aneksuara të Kosovës, kishin informacione të hollësishme mbi barbarizmat dhe mizoritë serbe ndaj popullsisë shqiptare. Ata, jo vetëm që nuk hezitnin, por kishin për detyrë t'i raportnin eprorëve të tyre realitetin e përditshëm në rajonet gjeografike dhe administrative në të cilat kishin kredenciale diplomatike.

Ploja e madhe ndaj shqiptarëve në Kabash

Përderisa në mënyrë të pleksur vazhdonte fushata e qarqeve serbe në Moravë të Epërme, ku situata paraqitej e brishtë për popullsinë shqiptare, një tjetër rast i rëndë tronditi shqiptarët dhe përfaqësuesit e huaj diplomatik. Rrjedhimisht, gjatë muajit nëntor 1913, epiqendër e mizorive serbe kundrejt shqiptarëve u bë fshati Kabash, i cili në strukturën etnike përbëhej plotësisht nga popullsi shqiptare. Për të

²² *Правда*, "Анархија у Новој Србији", година X, Број. 351, Београд, субота, 21 децембар 1913 год., стр. 1.

²³ Thoma Murzaku, *Kur u caktuan kufijtë e Shqipërisë (1912-1914) - (Me një epilog: Pse kjo çështje vazhdoi të diskutohej përgjatë disa dekadave të tjera)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 2017, f. 264.

²⁴ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor - dhjetor 1913)*, vëll. I, përgatiti Valentina Duka, Tiranë: Toena, 2012, f. 328. Raport i Crackanthorpe nga Beograd për Edward Grey në Londër, 5 nëntor 1913.

kuptuar më hollësisht rrjedhën kronologjike të ployës në Kabash, konsiderohet e arsyeshme të paraqiten në mënyrë të renditur kohore e analitike variantet e burimeve kryesore të origjinës serbe, shqiptare dhe ndërkombëtare, për të nxjerrë një konkluzion i cili ka për synim të vërtetën historike.

Për rastin e fshatit Kabash, në fund të nëntorit 1913, shkroi gazeta serbe *Pijemont*, e cila dilte në Beograd. Ajo kishte dërguar korrespondentin e saj në rrethin e Gjilanit, për të raportuar mbi të gjitha zhvillimet shoqërore, ekonomike dhe kulturore-arsimore në këtë trevë. Në artikullin me titull "I opet fratri" ("Dhe fretërit përsëri"), të botuar më 16/29 nëntor 1913, korrespondenti i kësaj gazete raportoi me notat më patetike, me gjykime dhe paragjykime, përçmime e urrejtje ndaj zhvillimeve të fundit në fshatin shqiptar të Kabashit. Korrespondenti e nisi raportimin me proverbin popullor "*Ujku qimen e ndërron, por zakonin asnjëherë*"*, që sipas mendimit të tij mund të atribuohet plotësisht për "*arnautët tanë*". Pavarësisht vendbanimit në Kosovë ose Shqipëri, sipas korrespondentit të *Pijemont*-it "*arnauti është i destinuar të jetë një hajdut dhe vrasës*". Rrjedhimisht, përshtypja dhe bindja e opinionit serb se shqiptarët ishin qetësuar dhe kishin ndryshuar pas pushtimit serb të rrethinës së Gjilanit, ishte vetëm një mashtrim. Përpjekja për të imponuar zanatin e vjetër, mosbesimi se Mbretëria e Serbisë nuk është njësoj sikurse Perandoria Osmane, hezitimi për të marrë mësim pas kryengritjes së shtatorit, ishin disa nga specifikat e të metave të shqiptarëve sipas vlerësimeve të korrespondentit të *Pijemont*-it. Sipas këtij raporti, shqiptarët, vetëm në gjashtë ditët e fundit kishin vrarë katër serbë në rrethin e Gjilanit. Fillimisht, më 4/17 nëntor 1913, në fshatin shqiptar Kabash, një grup i armatosur shqiptar kishte sulmuar një njësit të xhandarmërisë serbe prej 3 pjesëtarësh, me ç'rast mbeti i vrarë njëri prej xhandarëve. Trupi i pajetë i xhandarit serb u varros në Gjilan "*me pjesëmarrjen e tërë popullatës*". Të njëjtën ditë, sipas raportit të korrespondentit të *Pijemont*-it "*shqiptarët gjakatarë vranë dy serbë pas një prite në fshatin Letnicë*". Korrespondenti serb habitej pse të gjitha këto vrasje kishin ndodhur në afërsi të fshatit Letnicë, i cili ishte i përbërë kryesisht me shqiptarë katolikë dhe ishte çerdhe e fretërve shqiptarë në Moravë të Epërme. Ai ishte i bindur se nuk duhej menduar gjatë se shqiptarët katolikë po nxinin trazira dhe vrasje. Në fund, korrespondenti

* "*Вук длаку мења, али худ никако*".

i *Pijemont*-it u kërkonte autoriteteve përgjegjëse shtetërore serbe për t'i kushtuar vëmendje kësaj ngjarjeje dhe të gjitha shtëpive ku shqiptarët e armatosur gjenin strehim, sepse sipas tij “*nuk është e drejtë që serbët edhe sot nën Serbi të jenë viktimat të ekzekutuar nga arnautët*”.²⁵ Informacionet që paraqiten në gazetën beogradase pretendojnë se fretërit katolikë nxisin vrasjen e serbëve, të cilët i portretizonte si viktimat të gjoja krimeve të shqiptarëve. Në raportin e *Pijemont*-it nuk shënohen shkaqet dhe arsytet e vrasjes së serbëve, por indirekt bëhet propagandë për vrasjen e shqiptarëve, duke mos paraqitur asnjë të dhënë mbi sanksionet kundrejt tyre, që për autoritetet administrative ishin të pashmangshme.

Në të njëjtën linjë arbitrariteti, historiografia serbe e viteve 80-të të shek. XX dhe ajo e dekadës së dytë të shek. XXI, për ngjarjen e Kabashit shkruan: “*Deri në fund të vitit 1913 është regjistruar edhe një tjetër incident serioz me të jashtëligjshmit (kryengritësit shqiptarë - F. R.), të cilët më 13 nëntor në fshatin Kabash të rrethit të Gjilanit, kanë vlarë xhandarin (policin), këshilltarin komunal dhe një fermer nga fshati Binçë. Pastaj njësia ushtarake rrethoi fshatin dhe gjatë luftimeve zuri fajtorët; artileria nuk është përdorur*”.²⁶ Rrjedhimisht, ngjarja kualifikohet si ndodhi e papritur, ku bëhet fjalë për një grup të organizuar dhe të armatosur pa vënë theksin në identitetin e tij kombëtar ose etnik. Gjithashtu, lihen mënjandë motivet e vrasjes së zyrtarëve dhe jozyrtarëve serbë, por nënkuptohet se autorët e aktit janë kapur dhe janë ndërmarrë operacione ndëshkuese, për të cilat nuk shpalosen detaje.

Në përputhje me njëmendësinë e kujtesës popullore, të bazuar në provat e dëshmitarëve okularë, një grup kryengritësish shqiptarë, nën drejtimin e Rustem Januz Kabashit (1891-1914), pasi kishte zbarkuar nga terreni malor në fshatin Kabash kishte rënë në sy të një xhandari serb, i cili pjesëtarëve të grupit u kërkoi të dorëzoheshin. Mirëpo, grupi kryengritës shqiptar nuk pranoi dorëzimin dhe rrjedhimisht shtiu me armë ndaj xhandarit serb, duke e lënë të vdekur atë dhe një serb tjetër. Përballë kësaj rrethane ultimative dhe me pasoja vdekjeprurëse, pa marrë parasysh alarmin dhe kërcënimin e menjëhershëm për ndëshkime fatale, shqiptarët e fshatit Kabash nuk pranuan t'i lëshonin shtëpitë e të arratiseshin, sepse

²⁵ *Пижемонт*, "И опет фратри", Број 316 (година III), Београд, субота, 16 Новембра 1913 год., стр. 2.

²⁶ М. Јагодић, *Нови крајеви...*, ф. 244; Богумил Храбак, *Арбанашки упади и побуне на Косову и Метохији од краја 1912. до краја 1915*, Врање: Народни Музеј, 1988, ф. 73.

kjo sjellje mund t'i bënte fajtorë për vrasjet. Në vijim, organet administrative serbe, veçanërisht ato ushtarake e të xhandarmërisë, madje edhe civilë të armatosur serbë, në mënyrë të papërmbytur dhe në shenjë hakmarrjeje, gjatë mbrëmjes rrethuan tërë fshatin Kabash dhe në mëngjesin e ditës së nesërme arrestuan të gjithë meshkujt e moshës mbi 15-vjeçare. Më pas, të arrestuarit (54 veta e më shumë²⁷) i mbajtën të ngujuar dy ditë në “*Kullën e Mbretit*” në Viti. Në ditën e tretë i nisën në drejtim të Gjilanit, por në fakt me thika e bajoneta, pasi i plaçkitën i kishin masakruar e groposur në afërsi të fshatit Klllokot. Kësaj masakre i shpëtuan vetëm pesë të arrestuar. Veç kësaj, vrasje, djegie fizike e masakra u shënuan edhe në fshat gjatë aksionit të arrestimit të shqiptarëve që rezistonin. Pasi u plaçkiti i tërë fshati, veç dy shtëpive që i kishin shpëtuar flakëve të zjarrit, të gjitha të tjerat u dogjën, duke përfshirë plevicat e gardhiqet. Rrjedhimisht, në fshatin Kabash mund të soditeshin vetëm gërmadhat, ndërsa të mbijetuarit, kryesisht gra e fëmijë, u shpërndanë nëpër vendbanime të tjera shqiptare të Moravës së Epërme.²⁸

²⁷ Kujtesa popullore ka arritur të ruajë emrat e 44 të ekzekutuarve. Ata janë: Misin Sali Cenaj (52 v.), Murat Salih Cenaj (50 v.), Avdyl Salih Cenaj (34 v.), Hysen Jakup Cenaj (35 v.), Ibish Jakup Cenaj (52 v.), Isak Jakup Cenaj (31 v.), Agush Ahmet Cenaj (30 v.), Hamëz Nezir Cenaj (18 v.), Qerim Ali Cenaj (59 v.), Alush Ali Cenaj (26 v.), Hafiz Qerim Cenaj (22 v.), Halit Qerim Cenaj (20 v.), Azem Kamer Cenaj (48 v.), Sefedin Azem Cenaj (16 v.), Aziz Elez Cenaj (47 v.), Rexhep Çausheq Veselaj (63 v.), Smajl Bajram Veselaj (60 v.), Bajram Smajl Veselaj (39 v.), Hamit Selman Veselaj (50 v.), Jashar Islam Muçaj (60 v.), Islam Jashar Muçaj (30 v.), Murtez Brahim Muçaj (52 v.), Hamdi Murtez Muçaj (17 v.), Kadri Brahim Muçaj (37 v.), Isuf Brahim Muçaj (22 v.), Qamil Osman Muçaj (18 v.), Zenel Rexheq Muçaj (40 v.), Hazir Shaban Muçaj (45 v.), Qazim Hazir Muçaj (20 v.), Shabi Sadik Muçaj (37 v.), Ramadan Kuklubeci (30 v.), Rrahim Sallah Trakalaçi (53 v.), Ali Sallah Trakalaçi (50 v.), Hebib Ali Trakalaçi (25 v.), Aziz Avdyl Trakalaçi (47 v.), Rrustem Veli Trakalaçi (47 v.), Faik Aziz Trakalaçi (19 v.), Abaz Sallah Trakalaçi (65 v.), Veli Abaz Trakalaçi (45 v.), Shaban Veli Trakalaçi (17 v.), Hysen Abaz Trakalaçi (18 v.), Misin Luzha (mysafir, fshati Mogillë), Shefki Qerimi (mysafir, fshati Ballancë), Tahir Musliu (mysafir, fshati Ballancë). Shih më gjerësisht: N. Z. Bardhi, *Pushtimi dhe politika represive serbe...*, f. 174-176.

²⁸ Sabit R. Abdyli, *Kabashi i Anamoravës*, Prishtinë: Lorimex, 1997, f. 35-38; Hysen Terziu, *Gjenocidi serb 1912-1956*, Prishtinë: Iliriku, 2005, f. 52-53; Sabit Abdyli, “Masakra serbe e vitit 1913 në Kabashin e Anamoravës”, *Illyria*, nr. 474, New York, 26-29 gusht 2005, f.29; Sabit Abdyli, *Na Kabashi jem t'ndam nji zjarrmi*, Gjilan: Pika 5A, 2013, f. 24-31.

Argumenti se në Moravë të Epërme ekzistonte një veprimtari aktive e grupeve të armatosura klandestine shqiptare, nuk nënkuptonte qëllimin e tyre për të goditur popullatën civile dhe të paarmatosur serbe. Ato vepronin në grupe numerikisht të vogla dhe kishin për qëllim mbrojtjen individuale, familjare dhe për aq sa ishte e mundur të grupeve kolektive shqiptare nëpër vendbanimet e Moravës së Epërme. Përkundrazi, aktiviteti i grupeve të armatosura klandestine shqiptare vlerësohej shumë i rrezikshëm për qeverinë dhe administratën serbe, e cila e përdori atë si pretekst për të kryer brutalitet e mizori ndaj popullsisë së pambrojtur dhe civile shqiptare.

Pas disa javësh, për mizoritë në Kabash shkroi edhe shtypi periodik shqiptar. Sipas burimeve informative të *Përlindja e Shqipëniës*, e cila botohej në Vlorë, karakteristikë e qeverisë serbe përmes instrumenteve të pushtetit të saj në Kosovë ishte mohimi kategorik i alibisë së shqiptarëve mbi vrasjen e ushtarëve serbë. Në ngatërresat e brendshme të elementëve ushtarakë serbë, të cilat përfundonin me vrasjen e njëri-tjetrit, organet qeveritare serbe autorësinë e këtyre akteve ua vishnin dhe atribuonin shqiptarëve. Kështu, gjatë një përleshjeje të këtij lloji, që u zhvillua në një fshat të Moravës së Epërme ishin vrarë pesë ushtarë. Për të mbuluar ngatërresat që ishin ekspozuar me konflikt të armatosur të ushtarakëve së saj, qeveria serbe ua veshi fajin shqiptarëve, ku për rrjedhojë kishte dhënë urdhër për të sulmuar fshatrat shqiptare përreth. Aksioni për ndëshkimin e shqiptarëve kishte përfunduar me vrasjen e 300 vetave dhe djegien e shtëpive.²⁹ Autenticiteti i burimeve të tilla informuese nuk mund të llogaritet plotësisht i sigurt, veçanërisht te përcaktimi numerik i viktimave shqiptare. Megjithëkëtë, përmbajtja e tyre ka një mbështetje objektive, e cila bazohet para së gjithash nga rrëfimet që individë ose familje shqiptare të kësaj treve kishin emigruar në Shqipëri.

Mizoritë mbi shqiptarët e fshatit Kabash nuk u lanë pa u hetuar e interpretuar nga përfaqësuesit e huaj diplomatikë të akredituar në qytetin e Shkupit. Në këtë qytet, ku ishin aktive konsullatat e Fuqive të Mëdha, përfaqësuesit e diplomacisë britanike dhe austro-hungareze i paraqitën eprorëve të tyre informacione, të cilat janë me interes për verifikimin e të vërtetës historike mbi ployën e Kabashit. Sipas burimeve të informimit, që konsullata e Përgjithshme austro-hungareze siguronte nga vatra e

²⁹ “Qysh sillen Serberit me Shqipëtarët e Kosovës”, në *Përlindja e Shqipëniës*, nr. 35, Vlonë, 25/7 Dhetuer 1913, f. 4.

ngjarjes, i raportohej Vjenës zyrtare se në Kabash “*gra e fëmijë qenë hedhë të gjallë në flakë nga ushtarët* (serbë - F.R.)”. Në këtë masakër, sipas këtij raporti, kishte marrë pjesë edhe kryetari i komunës së Vitisë.³⁰ Pothuajse me një konstatim kategorik, që vrasjet ndaj serbëve i konsideronte si trillim, vinte nënkonsulli britanik në Shkup, W. D. Peckham. Sipas gjykimit të tij, “*në rastin e Kabashit... banda* (grupi i armatosur shqiptar - F. R.) *në fakt ka qenë pjellë e imagjinatës serbe*”.³¹

Duke analizuar dhe krahasuar me kujdes burimet e mësipërme, arrinte në konkluzionin se në gjakderdhjen e madhe kundrejt shqiptarëve në Kabash pati lidhje koherente dhe një simetri paraprakisht të menduar e të konstruktuar serbe, duke përfshirë organet ushtarake, paraushtarake, administrative e propagandistike. Rrjedhimisht, konstatohet se gjendja e përgjithshme e qarqeve shtetërore serbe ishte skajshmërisht e tendosur, përdërisa karakteri programor e shtetëror serb kërkonte agresivitet dhe brutalitet të vazhdueshëm kundrejt popullatës joserbe në Moravë të Epërme. Ndërsa dëmet materiale dhe njerëzore kundrejt shqiptarëve ishin të pallogaritshme dhe të pariparueshme. Për konsekuencë, kjo strategji politike kishte për qëllim shkatërrimin e hapësirës së domosdoshme jetësore të shqiptarëve.

Vrasja e kallogjerit serb Sebastian Nikoliq, një manovër e orkestruar për vijimin e krimeve në Moravë të Epërme

Ndër momentet e vështira që kaloi populli shqiptar në viset e Moravës së Epërme ishte edhe skandali “Nikoliq”, i cili erdhi si rezultat i vrasjes së kallogjerit ortodoks serb, Sebastian Nikoliq, më 10 nëntor 1913. Ai ishte murg superior në manastirin e Binçës në Moravë të Epërme.

Në vijim të këtij incidenti, gazeta serbe në Beograd, *Pijemont*, në artikullin me titull “Bugari ubijaju” (“Bullgarët vrasin”), të datës 16/29 nëntor 1913, nuk mund të nxirrte të dhëna të sakta për zbulimin e autorëve, por sipas supozimit të korrespondentit të saj, ishte e qartë se sikurse në vrasjen e priftërinjve të tjerë serbë edhe Sebastian Nikoliqi nuk përjashtohet se është viktimë e një atentati të orkestruar të organizatës

³⁰ *HHSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj.23-30-3075. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, H. Jehlitschka, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 4 dhjetor 1913.

³¹ R. Elsie & B. Destani (red.), *Kosova: një histori dokumentare...*, f. 282. Depeshe e W. D. Peckham nga Shkupi dërguar Dayrell Crackanthorpe në Beograd, 8 maj 1914.

bullgare-maqedonase (Komitetit Bullgar të Maqedonisë). Sipas raportit të korrespondentit të gazetës beogradase, vrasja e S. Nikoliqit ishte kryer para datës 10/24 nëntor 1913. *“Jeromonahu qe vrarë gjatë rrugës nga Gjilani për në manastir (të Binçës - F. R.) dhe u gjet në një gropë nga fshatarët, që po udhëtonin drejt Gjilanit”* - konstatonte korrespondenti i Pijemont-it. Në përshkrimin që i bëhet plagëve trupore të viktimës, theksohet: *“Megjithëse kufoma kishte plagë të shëmtuara, qe e mundur që të njihej se ajo ishte e Jeromonah Nikoliqit. Kufoma ka plagë plumbash dhe plagë të shkaktuara nga instrumente, që nuk presin. Pasi u bënë konstatimet nga autoritetet, kufoma qe dërguar në manastir”*. Kufoma e kallogjerit S. Nikoliq u varros në manastirin e Binçës. Autorët specifikë të kësaj vrasjeje nuk u zbuluan, por sipas argumenteve të kësaj gazete dyshimet orientoheshin në favor të supozimit të mësipërm mbi organizatorët e vërtetë të atentatit në fjalë, duke shpalosur bindjen se ky akt ishte vepër e organizatës bullgaro-maqedone, që sipas korrespondentit të saj gjithmonë përpiqet të shtrinte propagandën në viset administrative të Mbretërisë së Serbisë. Komiteti Bullgar i Maqedonisë vepronte me një numër të konsiderueshëm agentësh, hajdutësh, mercenarësh e spiunësh. Pohimin në fjalë kjo gazetë e mbështeste gjoja në njohuritë që kishin autoritetet administrative serbe për këtë rast, ku qenë arrestuar disa vetë, por që nuk ishin autorët e vërtetë të S. Nikoliqit. Gazeta serbe përfundonte se autorët me gjasë qenë arratisur në territorin administrativ bullgar dhe pretendonte se Mbretëria e Bullgarisë kishte dorë në këtë atentat, duke theksuar se ajo *“sigurisht i ka marrë pas vrasjes në prehrin e saj”*. Në këtë kontekst, korrespondenti i gazetës beogradase paraqiti pretendime më të thella, duke hulumtuar qendrën dhe aktivitetin e organizatës bullgare-maqedonase. Sipas tij, qendra e saj ishte një shtëpi në qytetin e Shtipit, në të cilën ishte organizuar komploti ndaj S. Nikoliqit, për zbulimin e vrasjes së të cilit ishte angazhuar edhe Inspektorati i Policisë në Shkup, në krye me Mihailo Ceroviqin dhe zyrtarë të tjerë të posaçëm.³²

Në ndërkohë, duke parë që vrasja e S. Nikoliqit kishte provokuar dhe inkurajuar një reagim serb kundrejt shqiptarëve në Moravë të Epërme, konsullata e Përgjithshme austro-hungareze në Shkup, u angazhua për disa ditë të verifikonte saktësinë e këtij lajmi sensacional.

³² *Пијемонт*, "Бугари убијају", Број 316 (година III), Београд, субота, 16. Новембра 1913. год., стр. 3.

Ajo ngarkoi njerëz të caktuar dhe të përgatitur enkas për sigurimin e informacioneve të hollësishme dhe të sakta. Për disa ditë me radhë, asaj i erdhën informacione të ndryshme që binin në kontrast të madh me variantin e gazetës beogradase dhe përgënjeshtrojnë pretendimin serb se atentati e kishte burimin nga qarqe të organizatave bullgare. Versionet që paraqet kjo konsullatë, në një raport të gjerë që iu dërgua Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, ndriçojnë dhe nxjerrin në sipërfaqe të dhëna interesante, që për bazë kanë përgënjeshttrimin e korrespondentit dhe gazetës serbe, mbi autorët dhe zbulimin e të vërtetës se atentati qe kryer nga strukturat shtetërore dhe joshtetërore serbe. Informacionet që siguroi kjo konsullatë, theksojnë se S. Nikoliqit pas vrasjes iu vodh një shumë prej 200 lirash osmane si dhe kali që e shfrytëzonte për raste udhëtimi. Raporti austro-hungarez, theksonte se, pasi “*frenat e kalit gjoja ishin gjetur në fshatin muhamedan Beguncë*”, serbët e lokaliteteve Binçë, Viti, Mogillë dhe Gërçar u grumbulluan me entuziazëm për t’u sulur në drejtim të fshatrave shqiptare Beguncë, Debëlldeh dhe Lubishtë, me qëllim që në shenjë hakmarrjeje t’i shkatërronin ato dhe të ekzekutonin popullatën e tyre. Mirëpo, duke parë që ky lajm kishte marrë shkallën e një tensioni serioz ndëretnik dhe me parametra të një konflikti të armatosur, kishte ndërhyrë kryetari i Vitisë, duke kërkuar nga serbët lokalë që të qetësoheshin përkohësisht dhe të mos ndërmerrnin përnjëherë asnjë aksion pa qenë të udhëzuar paraprakisht nga qeveria në Beograd. Mungesa e një aksioni të mëtejshëm, që ngërthente mjedise zyrtare dhe jozyrtare serbe, i kishte krijuar përshtypjen konsullatës së Përgjithshme austro-hungareze se qeveria në Beograd kishte këshilluar tërheqjen e serbëve lokalë nga aksioni i mësipërm, për shkak se reprezaljet e mëtejme ndaj shqiptarëve do të sillnin reagimin ndërkombëtar. Organet administrative serbe i druheshin përsëritjes së gjakderdhjes së madhe të Kabashit kundrejt shqiptarëve në fshatrat Beguncë, Debëlldeh e Lubishtë, për faktin se trupa diplomatike britanike në Beograd kishte siguruar informacione të besueshme për shkatërrimin dhe mizoritë serbe në fshatin Kabash.³³ Është e qartë se ky dhe të gjitha operacionet kundrejt shqiptarëve ishin të përpiluara dhe të zbatuara nën kontrollin dhe komandën e plotë të shtetit serb.

³³ *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj.23-30-3075. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, H. Jehlitschka, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 4 dhjetor 1913.

Në vijim të informacioneve të paraqitura në raportin austro-hungarez, hetimet në pistën e vrasjes së S. Nikoliqit implikonin kryetarin e komunës së Vitisë, i cili e kishte planifikuar dhe realizuar vrasjen përmes komitëve të paguar. Kryetari i komunës së Vitisë kishte pasur armiqësi me S. Nikoliqin, sepse ky i fundit kultivonte raporte të mira me shqiptarët katolikë dhe *"thuhet se i ka mbrojtur ata vazhdimisht"*. Një version tjetër që shpaloset në raportin e konsullatës së Përgjithshme austro-hungareze ishte se vrasja e S. Nikoliqit u bë për motive gjakmarrjeje, sepse kallogjeri i manastirit të Binçës para dy muajve kishte vrarë rastësisht një serb, për çka kishte rezultuar me arrestimin dhe lirim të tij pas tri ditësh. Mirëpo, vëllai i të vëllit/viktimës serbe pas dy muajsh e qëlloi për vdekje S. Nikoliqin. Në përfundim të raportit austro-hungarez, arrihet në këtë konkluzion: *"Nga faktet e përmendura më lart mund të thuhet se artikulli i shkruar me pasion i gazetës "Pijemont" siç duket i frymëzuar, është një kryevepër e shtrembërimeve serbe"*.³⁴ Rrjedhimisht, pretendimi i qarqeve propagandistike serbe që vrasjet e individëve ose klerikëve fetarë në zona lokale t'i radhitnin në suazat e një organizimi me bazë jashtë territorit administrativ serb, pashmangshëm janë alogjike dhe nuk përkohjnë me realitetin e kohës. Hetimi disaditësh që bënë burimet e informimit të konsullatës së Përgjithshme austro-hungareze në Shkup, demaskojnë dhe denoncojnë politikën perfide të qarqeve qeveritare dhe proqeveritare serbe kundrejt viseve të pushtuara dhe aneksuara Mbretërisë së Serbisë.

Pikëpamja se vrasja e kallogjerit S. Nikoliq përbën një moment skandaloz të qarqeve zyrtare dhe shtypit periodik serb, mbështetet në disa argumente kryesore. Pikësëpari, në strukturën etnike të vendbanimeve në Moravë të Epërme, nuk kishte asnjë fshat me element bullgar, për të mundësuar një substancë shkakësore me motive hakmarrëse nga një organizatë bullgaro-maqedone. Veç kësaj, spekulimi dhe insistimi i rrethëve propagandistike serbe për të pretenduar atentatorët me bazë Mbretërinë e Bullgarisë, kishte në thelb dy qëllime elementare: nxitjen e urrejtjes dhe konfliktit kundrejt elementit bullgar nën sundimin serb si dhe kundrejt Mbretërisë së Bullgarisë³⁵, që mendohej se mund të ishte një aleate e ardhshme e Shqipërisë dhe Perandorisë Osmane kundër

³⁴ *По ату.*

³⁵ *Полтика*, "Српско-бугарски односи.", Број. 3571, Београд, петак, 20 децембра 1913. год., стр.1.

Mbretërisë së Serbisë³⁶; dhe vazhdimin e zbatimit të politikave brutale e mizore kundrejt shqiptarëve në Moravë të Epërme dhe më gjerë. Në këtë drejtim, programi shtetëror për asimilimin e Moravës së Epërme nuk kursente as pjesëtarët e kombit serb, sepse përdorimi i konflikteve ndërmjet strukturave zyrtare dhe jozyrtare serbe, në funksion të politikës së shkatërrimit sistematik dhe të tërësishëm të një popullsie me veti e karakteristika të tjera, ishte parim rrënjësor i politikës shtetërore serbe. Prandaj, vrasja e kallogjerit të manastirit të Binçës, e orkestruar për të mos u ditur zyrtarisht shkaqet dhe autorët e vërtetë të aktit kriminal, përbën një skandal të madh dhe të pajustificueshëm të Mbretërisë së Serbisë në Moravë të Epërme.

Presioni për serbizimin e shqiptarëve katolikë

Në Moravë të Epërme, në kuadër të procesit të asimilimit sistematik, shteti serb cenoi edhe popullsinë shqiptare katolike. Kishat katolike në Letnicë dhe Stubëll të Moravës së Epërme gëzonin statusin e famullive, mbështetjen dhe përkujdesjen financiare të pakontestueshme të Austro-Hungarisë, e drejtë e njohur prej periudhës osmane.³⁷ Famullitë katolike në Moravë të Epërme i takonin juridiksionit katolik të Shkupit, por prej tetorit të vitit 1912 pothuajse tërësisht e kishin të vështirë të vijonin kontaktin dhe komunikimin me Shkupin. Kërkesat e tyre nuk mund të procedoheshin e realizoheshin për shkak të gjendjes së brishtë të sigurisë, që mbretëronte në viset e Moravës së Epërme. Gjithashtu, furnizimi i tyre me materiale të nevojshme ishte i pamundur.³⁸

Në nëntor 1913, dom Zef Ramaj, i lindur në Stubëll, famullitar i kishës katolike të Shkupit, realizoi me vështirësi një vizitë në famullitë katolike në fshatrat Letnicë dhe Stubëll. Midis të tjerash, problemi kryesor që famullitarët e këtyre fshatrave i paraqitën dom Zef Ramajt, ishte kërkesa dhe presioni i kryetarit të Zhegrës, i cili zyrtarisht i sugjeronte, madje me insistim dhe imponim, famullive në fjalë që të hapnin shkollat e famullive dhe të deklaroheshin se gjoja kishin dëshirë

³⁶ *Правда*, "Арнаутско-бугарски напади на Србију", (година X), Број. 249, Београд, уторак, 10. септембар 1913 год., стр. 2; *Правда*, "Опасна ситуација", (година X), Број. 351, Београд, субота, 21. децембар 1913 год., стр. 1.

³⁷ М. Јагодић, *Нови крајеви...*, f.510.

³⁸ *ННSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 23-12-1300. Raport i konsullatës austro-hungareze në Shkup dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 31 maj 1913.

që në këto shkolla të mësohej gjuha serbe me shkronja të alfabetit cirilik. Veç kësaj, dom Zef Ramajn dhe famullitarët e fshatrave në fjalë i shqetësonte fakti që organet administrative serbe kishin në plan të hapnin një shkollë serbe në fshatin Binçë, që hynte në kufijtë administrativë të komunës së Vitisë. Në këtë fshat jetonin 30 familje shqiptare katolike dhe 50 familje ortodokse serbe. Synimet për serbizimin e kësaj treve shqiptare katolike kishin për qëllim që në krye të kësaj shkolle të vendosej një mësues serb. Ky shqetësim u bart edhe tek argjipeshkvi Lazër Mjeda, për të marrë mendimin e tij lidhur me këtë gjendje të rëndë të komunitetit shqiptar katolik në Stubëll, Binçë etj. Përgjegjësi diplomatik në konsullatën austro-hungareze në Shkup, H. Jehlitschka, mori përsipër që këto rrethana të vështira t'ia përcillte ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, L. Berchtold. Diplomati austro-hungarez mendonte se ishte e papranueshme që gjuha serbe dhe alfabeti cirilik të zbatoheshin në shkollën e famullisë në Stubëll, që, sipas argumenteve të H. Jehlitschka, “*ka krejtësisht karakter shqiptar*”, ndërsa gjuha sllave ishte plotësisht e panjohur. Konsulli i Përgjithshëm austro-hungarez, vlerësonte se, pretendimeve të organeve administrative serbe, për të shtrirë ndikimin e tyre në shkollat e kultusprotektoratit austro-hungarez, duhej t'i kushtohej vëmendje e duhur. Ai paralajmëronte sanksione shtetërore austro-hungareze kundrejt shtetit serb në rast se këto përpjekje bëheshin reale.³⁹ Cenimi i pavarësisë dhe i të drejtave funksionale kishtarë të shqiptarëve katolikë prekte drejtpërdrejtë interesat e Austro-Hungarisë, të drejta të fituara ndër shekuj për të mbrojtur dhe për t'u përkujdesur mbi të krishterët katolikë dhe investimet milionëshe që ajo kishte shpenzuar deri në atë kohë në shërbim të nevojave të kishave katolike. Pa dyshim, nëse cenoheshin interesat e saj, atëherë reagimi austro-hungarez ishte i pashmangshëm dhe do të rriste stadin e tensionit midis Perandorisë së Austro-Hungarisë dhe Mbretërisë së Serbisë.

Politika demonizuese dhe shkatërruese serbe kundrejt veprimtarëve të lëvizjes kombëtare

Gjatë kësaj periudhe në Moravë të Epërme vërehet një politikë koherente serbe për demonizimin, stigmatizimin dhe eliminimin fizik të veprimtarëve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Strukturat ushtarake dhe

³⁹ *Po aty*, Vj. 23-30-3070. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, H. Jehlitschka, dërguar ministrit L. Berchtold në Vjenë, Shkup, 19 nëntor 1913.

administrative serbe, me të gjithë mekanizmat zyrtarë dhe jozyrtarë, kishin përqendruar vëmendjen për të mbajtur nën kontroll të plotë ose për të eliminuar krerët shqiptarë që nuk pranonin pushtimin, aneksimin dhe sundimin serb. Në këtë linjë, shtypi radikal serb ishte një mjet pararendës propagandimi dhe mbështetës i fuqishëm i politikës shtetërore, që në opinionin lexues të publikonte artikuj me përmbajtje jashtëzakonisht armiqësore ndaj personaliteteve popullore shqiptare.

Shtypi radikal serb vazhdoi të publikonte artikuj në faqet e gazetave, që kishin përmbajtje për gjoja krimet e shqiptarëve kundrejt elementit serb gjatë periudhës osmane, përmes të cilëve nxisnin urrejtje, akte terrori, represioni dhe ekzekutime të shqiptarëve, me theks të veçantë ndaj figurave dhe familjeve patriotike shqiptare të kësaj treve. Në shënjestër të tyre ishin edhe Bislim Hogoshti e Hamdi Novobërda, veprimtar të njohur në rrethin e Gjilanit. Gazeta serbe në Beograd, *Pijemont*, më 2/15 dhjetor 1913, publikoi një dokument të vitit 1909, sipas të cilit 18 priftërinj ortodoksë të kazasë së Gjilanit i ankoheshin autoriteteve lokale, rajonale dhe qendrore të vilajetit të Kosovës, për gjoja krimet e shqiptarëve ndaj serbëve dhe priftërinjve lokalë. Me akuzat për vrasje profesionale ngarkoheshin Bislim Hogoshti, Hamdi Novobërda etj.⁴⁰ Bislim Hogoshti dhe Hamdi Novobërda ishin personalitete të shquara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në rrethin e Gjilanit.⁴¹ Lidhur me këtë, vlen të theksohet se Bislim Hogoshti gjatë kësaj kohe ndodhej në Vlorë, si përfaqësues i trevave të Anamoravës, sepse kishte dhënë një kontribut të theksuar në luftën e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi.⁴²

Duke analizuar me kujdes synimet e propagandës së shtypit radikal serb, arrihet në tri konkluzione themelore. *Së pari*, kjo gazetë angazhohej që në opinionin serb të krijonte përshtypjen se Bislim Hogoshti, Hamdi Novobërda etj., ishin “personalitete kriminale”, veprimtaria e të cilëve vazhdonte të paraqiste “rrezik” për jetën e serbëve në rrethin e Gjilanit. Në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkohej ekzekutimi i tyre në kushte të favorshme për autoritetet përgjegjëse. *Së dyti*, gjuha e urrejtjes, e përdorur nga korrespondenti dhe redaksia e gazetës në fjalë, motivonte

⁴⁰ *Пижемонт*, "Један интересантан докуменат", Број 332 (година III), Београд, понедељак, 2. Децембра 1913. год., стр. 1.

⁴¹ Aliriza Selmani, *Gjilani me rrethinë 1908-1912*, Lidhja e Historianëve Shqiptarë “Ali Hadri”, Prishtinë: 1998, f. 212.

⁴² Shaban Braha, *Idriz Seferi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Tiranë: 8 Nëntori, 1981, f. 207.

automatikisht veprime me karakter krimi të vazhdueshëm ndaj popullsisë shqiptare. *Së treti*, publikimi i artikujve me përmbajtje të tillë, lë të nënkuptohet se Mbretëria e Serbisë prodhonte dhe financonte kategoritë periodike dhe gazetareske serbe me karakter radikal, për të përligjur dhe realizuar platformën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore-arsimore, që kishte për epilog shkatërrimin e popullsisë shqiptare, të pasurisë e trashëgimisë së saj.

Pak javë më pas, *Pijemont* vijoi serinë e publikimit të artikujve me të njëjtën përmbajtje, duke i cilësuar veprimet e shqiptarëve si aktivitete të “*arnautëve kriminelë*”. Duke vazhduar me rikujtimin e ngjarjeve në Kabash, korrespondenti i kësaj gazete raportonte: “*Ata, siç kam raportuar tashmë, kanë vrarë katër serbë, para dy ditësh ndezën fshatin Mogillë dhe atje vranë e grabitën një shqiptar. Të gjitha përpjekjet për kapjen e këtyre zuzarëve ishin të pasuksesshme*”.⁴³ Në këtë kontekst, qendër e sulmeve ishte edhe Isa Boletini, i cili gjatë kësaj kohe vepronte aktivisht në Shqipëri për konsolidimin e shtetit shqiptar dhe për çlirimin e trevave shqiptare të aneksuara Mbretërisë së Serbisë dhe Malit të Zi. Pa dyshim, krerët e qëndresës së armatosur në Moravë të Epërme mbanin lidhje me Isa Boletinin, për të vazhduar përpjekjet për çlirimin e trevave shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë. Meqë Isa Boletini kishte probleme shëndetësore, por pa rrezik për jetën e tij, *Pijemont* konsideronte se “*do të ishte mëkat nëse ky zuzar do të vdiste i sëmurë në shtrat*”.⁴⁴ Në këtë kohë, krerë në zë nga Morava e Epërme, si Islam Pira e Hamdi Kurteshi po qëndronin në Shqipëri. Si pasojë e kësaj politike, Zeqë Pira nga Pozherani dhe Fetah Goshica ishin vrarë nga ushtria serbe gjatë Luftës së Parë Ballkanike, ndërsa Bislim Çausi - Begunca, Halim Begunca, Murtez Begunca, Zejnë Lubishta, Ramë Toplana etj., për shkak të persekutimit të vazhdueshëm, jetuan e vepruan në mënyrë klandestine. Thuajse në çdo fshat me shqiptarë në Moravë të Epërme kishte veprimtarë aktivë, të cilët në forma të ndryshme kundërshtonin dorëzimin dhe nënshtrimin e tyre ndaj zgjedhës serbe.⁴⁵

⁴³ *Пијемонт*, "Гиљански догађаји", Број 326 (година III), Београд, уторак, 26. Новембра 1913. год., стр. 2.

⁴⁴ *Пијемонт*, "Иса Бољетинац", Број 272 (година III), Београд, четвртак, 3. Октобра 1913. год., стр. 2.

⁴⁵ Sadulla Brestovci, *Lëvizja Kombëtare në kazanë e Gjilanit - Islam Pira (1866-1931)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 2008, f. 155-197.

Në dhjetor 1913 në Gjilan, në vazhden e persekutimit dhe luftimit të figurave patriotike të lëvizjes kombëtare nga Morava e Epërme, u ekzekutuan Shabi Kajolli dhe dy djemtë e tij nga Skifteraj dhe Fetah Sadovina nga Sadovina, të cilët ishin shquar për qëndresë të armatosur kundër pushtetit të mëparshëm osman e atij serb dhe njiheshin si prijës luftarak për liri dhe pavarësi kombëtare. Familjet e tyre prej tetorit 1912 përndiqeshin nga pushteti ushtarak serb dhe strukturat e tij.⁴⁶ Në këtë kohë, ushtrohej një presion dhe persekutim i vazhdueshëm fizik e psikologjik edhe ndaj tribunit popullor Idriz Seferi, i cili kishte vlerësuar të rëndësishëm qëndrimin e tij në vendlindje, si reflektim pozitiv ndaj popullsisë shqiptare për të qëndruar në vatrat e saj dhe për të mos zgjedhur rrugën e emigrimit, sepse ai kishte besimin që pushtimi serb në Kosovë nuk mund të përjetësohej.⁴⁷

Përçmimi, burgosja, internimi dhe ekzekutimi i krerëve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ishte synim permanent i qarqeve serbe, sepse njëkohësisht minimizonte revoltat e armatosura të shqiptarëve, u impononte atyre pranimin e pushtetit serb me të gjitha institucionet dhe mekanizmat e tij ose i nxiste ata që në mënyrë masive të rreshtoheshin drejt rrugës së emigrimit në Shqipëri, Perandori Osmane etj. Krerët popullorë në Moravë të Epërme ishin protagonistët kryesorë të qëndresës dhe ruajtjes së shqiptarisë së kësaj treve, prandaj një numër i tyre që arritën t'i shpëtonin programit shtetëror serb, përmes jetës klandestine dhe mbajtjes së linjave të komunikimit me personalitetet politike në Shqipëri, ishin të bindur se konsolidimi i pushtimit dhe aneksimit serb në këto treva ishte i parealizueshëm. Lidhja me atdheun, me familjen dhe shpresën për të ardhmen, ishin faktorët kryesorë që e penguan formësimin e doktrinës politike serbe kundrejt shqiptarëve në Moravë të Epërme.

Përfundimi

Krimet serbe me pikësynim shkatërrimin e plotë të shqiptarëve në Moravë të Epërme, nisën që prej tetorit të vitit 1912, për të vazhduar me

⁴⁶ *АВИБ*, П. 2, К. 13, Ф. 1, бр. 1/71, Команда Места Гњилане Команданту Косовске Дивизије, 2. фебруар 1913 год.; Hysen Terziu, *Ramë Abdylly dhe bashkëluftëtarët e tij*, Prishtinë: Iliriku, 1997, f.145-153; Esat Kamberi, “Kush ishte Shabi Kajolli i I-rë”, *Paqja* (Revistë për aktualitet, kulturë, arsim, etikë), viti X, nr.95 (19 prill - 19 maj 2015), Prishtinë: Zëri ynë, 2015, f.15.

⁴⁷ *HHS.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 23-30-3090. Telegram i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, H. Jehlitschka, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 26 dhjetor 1913.

një ritëm të ri pas shpalljes zyrtare të aneksimit. Ngritja në nivel statusi administrativ e vendbanimeve me elementë serbë, mospranimi i realitetit të ri nga ana e shqiptarëve, forcimi i programit shtetëror për shkatërrimin e shqiptarëve, cenimi i të mirave dhe i simboleve kulturore e fetare, mizoritë në Kabash, skandali “Nikoliq”, presioni për asimilimin e shqiptarëve katolikë, dhuna e të gjitha formave, shkatërrimi i veprimtarëve të lëvizjes së qëndresës së armatosur për mbrojtje dhe çlirim etj., ishin disa nga hallkat kryesore që përbënin zinxhirin e krimeve të zgjedhës serbe në Moravë të Epërme gjatë muajve shtator-dhjetor 1913. Në të gjitha këndvështrimet dhe burimet dokumentare e jodokumentare, konstatohet një sinkroni në veprimtarinë antishqiptare të qarqeve shoviniste dhe radikale serbe, pallatit mbretëror, qeverisë, kuvendit, administratës, popullsisë civile, qarqeve akademike, shtypit periodik dhe institucioneve fetare, për të realizuar tri objektiva parësorë kundrejt shqiptarëve: serbizimin, spastrimin etnik ose shkatërrimin biologjik të tyre. Pra, synimi përfundimtar ishte formësimi i një fizionomie të re në këto treva, me karakter plotësisht serb.

S u m m a r y

THE SCENARIO OF SERBIAN CRIMES IN UPPER MORAVA (SEPTEMBER-DECEMBER 1913)

The crimes committed by the Serbian Kingdom against Albanians during the Balkan Wars are relatively known in the national and international historiography. In this context, in a short overview on Kosovo is included also Upper Morava as a prelude to Serbian crimes against Albanians. The violence on physical and mental integrity, the intentional creation of hard living conditions, various forms of oppression, bullying, tortures, expropriations of real estates, exiles, imprisonments, by-design obstruction of creating families, ethnic cleansing and the executions of the defenseless Albanian civilian population are some of the main elements that feature the new orchestrated Serbian state's campaign which openly targeted the Albanians of Upper Morava during September-December of 1913. It is interesting to look at the

appalling staged cases of Serbian crimes that were blamed on another ethnic group: Albanians or Bulgarians. Through an analyses of Albanian, Serbian and international sources are viewed the questions at stake, are compared data and are drawn reliable conclusions on historical truths.